

## Raport nga vizita studimore në Kroaci

---

### Pjesëmarrësit:

**MMPH:** Luan Nushi, Elvida Pallaska, Zana Mehmeti, Besim Gollopeni dhe Ismail Gagica

**MMBPZHR:** Fatime dhe Ismail

**ALUP:** Fatmir Selimi

### Takimet u organizuan në:

**Niveli qendror - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe ndërtimit**

Vlatka Gjurković – zv. e ministrit

**Niveli qendror - Enti Shtetëror për Planifikim Hapësinor**

Antun Paunovic - Drejtori i entit për planifikim dhe stafi i tij,

**Niveli qendror - Ministria e Kulturës**

Zoran Šikić - zv i ministrit dhe stafi i tij,

**Niveli rajonal - Rajoni - Krapinsko-Zagorska Zhupanija**

Zëvendës udhëheqës i rajonit me stafin e tij

**Niveli komunal - Komuna – Sveti Krizh**

Ivan Kranjčić - kryetari të komunës me stafin

**Niveli komunal - Komuna – Delnice**

Ivica Briski - zëvendës kryetari i komunës

**PN "Risnjak" - Drejtoria e parkut**

Miljenko Gashparac - drejtor i parkut

Me kërkesën tonë dhe nën përkrahjen e projektit për Menaxhimin e Tokave Bujqësore – ALUP kemi organizuar udhëtimin studimor në Kroaci.

Qëllim i vizitës ishte njohja me strukturat dhe përgjegjësit e nivelit qendror dhe lokal lidhur me trajtimin, planifikimin dhe implementimin e planeve hapësinore për zona të veçanta me përqendrim në parqet nacionale, relacioni komunë, rajon dhe niveli qendror si dhe njohuri lidhur me zhvillimin rural.

Për gjatë tre (26–28 / 06 / 2007) ditëve të vizitës janë organizuar disa takime me rëndësi, në mesin e të cilave është takimi në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Ministrinë e Kulturës dhe takimet e nivelit rajonal në rajonin e Krapinsko-Zagorska Zhupanija si dhe takime të nivelit lokal në komunën e Sveti Krizhit dhe komunën e Delnices.

Në të gjitha takimet, pas prezantimit nga ana e nikoqirëve për gjendjen në sektorin e tyre, zhvilluam diskutime nga të cilat u përpoqëm sa më shumë që është e mundur të përfitojmë nga përvoja e tyre.

Pjesa më e rëndësishme e kësaj vizite ishte organizimi shumë i mirë, mikpritja e ngrohtë si dhe ndërtimi i lidhjes dhe raportit me institucionet dhe ekspertët kroat.

Në fund të vizitës u zotua dhe në të njëjtën kohë morëm konfirmimin se për një kohë të caktuar do të mundohemi që një delegacion i ngjashëm kroat do të mund të vizitonte Kosovën dhe për së afërmi të njihet me hallet dhe problemet tona.

## Takimi në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Takimi u organizua në lokalet e Ministrisë, konkretisht në zyrat e Entit shtetëror për Planifikim Hapësinor. Pas një pritje shumë të ngrohtë, nga ana e nikoqirit znj. Zëvendëse e Ministrit u prezantua në formë të shkurtër Ministria që ajo përfaqëson.

Kroacia është njëra ndër vendet e ish Jugosllavisë me më shumë përvojë në fushën e planifikimit. Republika e Kroacisë në vitin 1972, ka qenë e para e cila e ka hartuar planin hapësinor për të vazhduar më tutje me të gjitha planet e të gjitha niveleve. Sipas znj. Gjurković, sa i përket planifikimit hapësinor, sot në Kroaci është gjendja shumë më e mirë, pothuaj se nuk ka vend të pa mbuluar me plan. Ligjin të cilin e kanë nxjerrë në vitin 1994, në bazë të kërkesave dhe gjendjes në terren janë detyruar ta plotësojnë disa herë deri më tash. Sot jemi në prag të aprovimit të variantit të rij të Ligjit për Planifikim Hapësinor, në të cilin janë paraparë disa amendamente nga të cilët më i rëndësishmi është ai që përcakton statusin e ri të Entit shtetëror për Planifikim Hapësinor. Me këtë amendament, Enti i cili ka qenë pjesë e Ministrisë, nga tash e tutje do të bëhet me status gjysmë të pavarur, që do të thotë një pjesë e të hyrave do të realizohet nga puna me palët e treta.



### Enti shtetëror për Planifikim Hapësinor

Më tutje me një prezantim më të gjatë nga ana e drejtorit të Entit shtetëror për Planifikim Hapësinor, mësuam për punën dhe të arriturat e këtij institucioni. Në Kroaci ekziston edhe niveli rajonal (Zhupanija - 21) gjë që e ndryshon situatën nga ajo që është në Kosovë. Prandaj, përpos Entit shtetëror ekzistojnë edhe Entet në nivelin e Zhupanive, të cilat merren dhe janë përgjegjëse për planet e territorit që mbulojnë.

Në Ent sot punojnë 15 punëtorë të ndarë në disa seksione nga të cilët pjesa më e madhe janë me ngritje superiore.

#### Organizimi

- Sektori për planifikim strategjik
  - Njësia për planifikim kombëtar
  - Njësia për programe të veçanta dhe bashkëpunim ndërkombëtar
- Sektori për koordinimin e zhvillimit hapësinor rajonal dhe planifikimit urban
- Sektori për koordinim dhe planifikim të zonave me destinim të veçantë
- Sektori për hulumtim dhe baza e shënimeve të zhvillimit hapësinor
  - Njësia për hulumtim dhe monitorimin procesit në hapësirë
  - Njësia e bazës së shënimeve të zhvillimit hapësinor

Enti merret me hartimin dhe monitorimin e implementimit të Strategjisë dhe Programit të zhvillimit hapësinor të Republikës së Kroacisë dhe dokumenteve tjera të cilat i nxjerrë Kuvendi i Kroacisë. Enti gjithashtu merret me hartimin e Programit të përmirësimit të gjendjes në hapësirën e Republikës së Kroacisë, merret me hartimin e bazave hapësinore për shfrytëzimin e hapësirës së Republikës dhe raportin periodik për gjendjen në hapësirën e Republikës së Kroacisë. Në kuadër të fushëveprimit të Entit janë edhe punët tjera profesionale hulumtuese të cilat ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në hapësirë.

Një situatë e ngjashme me atë në Kosovë është problemi me staf, të cilët në kërkim të kushteve më të mira ekonomike çdo ditë e më shumë po i lëshojnë institucionet shtetërore. Një hap i rëndësishëm në pengimin e kësaj dukurie është duke u bërë me ndryshimin e statusit të Entit, me çka ofrohen mundësi për shtimin në radhë të parë të efikasitetit në punë dhe përfitimeve më të madha ekonomik.

Sa i përket planeve për zona të veçanta, gjegjësisht parqet nacionale, Enti është përgjegjësi kryesor për hartimin dhe implementimin e tij. Sipas drejtorit, në gjithë Kroacinë ekzistojnë disa zona të mbrojtura (90% e të cilave janë në Adriatik) në mesin e të cilave hynë edhe Parku Nacional "Risnjak". Hap i parë në plan është përshtatja me rregullat e Bashkësisë Evropiane, që shpesh kërkon një angazhim të mundimshëm. Parimi kryesor për parqet është "sa më shumë vizitor në Park dhe sa më pak qëndrim në të". Në këtë rast, vizitorëve ju ofrohet qëndrim më i gjatë jashtë kufijve të parkut, gjë që vendbanimeve afër parkut u epet rast shumë i mirë i zhvillimit. Kufijtë e parkut duhet të përcaktohen në fazën e hartimit të planit, deri më tash kufijtë janë ndryshuar tre herë në favor të sipërfaqeve të reja të cilat janë inkorporuar në Park. Një problem janë vendbanimet brenda Parkut, të cilat kanë rezhim të caktuar dhe strikt. Banorëve u lejohen disa veprimtari nga të cilat më e rëndësishmja është bujqësia (prodhime dhe gjithë ajo që është e lidhur me traditën).

Një informatë me rëndësi është se i njëjti Ent viteve të 70-ta ka hartuar një projekt për shfrytëzimin e terreneve të skijimit në Malet e Sharrit dhe një plan ideor për rregullimin e Kanionit të Mirushes (1987). Nga drejtori dhe bashkëpunëtorët e tij na u premtua që një kopje nga këto plane do të na dërgojnë në adresën tonë.

### Takimi në Ministrinë e Kulturës

Takimi u organizua në objektet e Ministrisë së Kulturës nën udhëheqjen e z. Zoran Shikiq, asistent i Ministrit për çështjet e zonave të mbrojtura. Në takim morën pjesë edhe disa punonjës përgjegjës për fusha të ndryshme. Gjatë prezantimit detaj të punës dhe të arriturave të Ministrisë në mes tjerash u njoftuam me organizimin, sektorët dhe ligjet që mbulon kjo Ministri. Legjislacioni në këtë fushë ekziston që nga viti 1949 dhe sot është në fuqi ligji i fundit që është aprovuar në vitin 2005. Qëndrimet dhe rregullativa janë dhe duhet të jenë në harmoni me ato të Bashkësisë Evropiane (Kroacia është nënshkruese e të gjitha konventave – e fundit është ajo për mbrojtjen e balenave). Në kuadër të Ministrisë është Drejtoria për Mbrojtje të Natyrës e cila është e përbërë nga disa njësi: Shfrytëzimi i qëndrueshëm i natyrës; Statistika; Biodiversiteti; Njësia për Zonat e Mbrojtura; Njësia për Çështje Juridike dhe Inspekcioni. U prezantuan edhe disa aspekte të përgjegjësisë të ndara në mbrojtjen dhe menaxhimin e parqeve nacionale. Institucion me rëndësi në këtë fushë është edhe Instituti Qendror për Mbrojtjen e Natyrës i cili momentalisht është subjekt i pavarur dhe të 30-të punëtorët sa ka në Institut, kryesisht merret me hulumtime dhe analiza. Në kuadër të kësaj strukture institucionale ekzistojnë edhe Institutet Rajonale të Mbrojtjes së Natyrës të cilët kryesisht merren me punë profesionale.



## Struktura

- Ministria e Kulturës (punët udhëheqëse)
  - Institucionet publik (drejtoria) për udhëheqjen me parqe nacionale dhe parqeve të natyrës (zonat me interes shtetëror)
  - Enti shtetëror për mbrojtjen e natyrës (punët profesionale)
- Rajoni (Zhupania)
  - Enti rajonal për mbrojtjen e natyrës (punët profesionale)
  - Institucionet publik për udhëheqjen me një pjesë të zonave të mbrojtura të nivelit rajonal dhe lokal (zonat si: rezervatet, rezervatet e veçanta, parqet rajonale, përmendoret e natyrës, pejsazhe të rëndësishme, park-pujet dhe përmendoret e arkitekturës së parqeve)

Një punë e rëndësishme është duke u bërë në ndërtimin e bazës së shënimeve, e cila do të krijojë kushte që gjendja të monitorohet më me efikasitet. Në Kroaci 9.5% e territorit është nën mbrojtje, mesatare e cila i përgjigjet kriterëve të shteteve të zhvilluara.

Një mundësi e mirë dhe trend i ri është dhënia në koncesion e parqeve nacionale, p.sh. PN "Brioni" është në fazën përfundimtare të tenderimit dhe shumë shpejtë do të dihet se kush do të menaxhojë me këtë hapësirë.

## Takimi në rajonin (Zhupania) e Krapinës dhe Zagories

Pas takimeve të suksesshme që patëm dje me nivelin qendror sot u organizua një takim me strukturat udhëheqëse rajonale. Në takim ishte prezent nënkryetari i rajonit i cili me një prezantim të shkurtër dhe efikas na tregoi për rajonin, problemet dhe të arriturat. Rajoni i Krapinës dhe Zagories në dy vitet e fundit, është njëri ndër gjashtë rajonet më të zhvilluara në Kroaci.

Në takim ishin prezent edhe stafi udhëheqës i Entit Rajonal për Planifikim Hapësinor, me të cilët patëm diskutim shumë të frytshëm. Nga ana e drejtoreshës së Entit mësuam për organizimin e këtij institucioni, problemet, të arritura dhe raporti me Entin shtetëror të planifikimit. Enti rajonal është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e realizimit të PH të rajonit i cili duhet të jetë në harmoni të plotë me PH të Republikës sidomos në aspektin e infrastrukturës teknike. Në kuadër të rajonit janë vetëm pesë njësi të vetëqeverisjes pa plan hapësinor të aprovuar, që do të thotë se pjesa më e madhe e territorit është e mbuluar me plane.



Standardizimi i hartimit të planeve ishte njëra ndër çështjet që u diskutua. Në Kroaci është aprovuar një katalog i shenjave dhe simboleve, të cilave të gjithë që merren me hartimin e planeve duhet ti përmbahen. Gjendja e planifikuar dhe ajo në terren, pothuajse janë identike, nuk ka ndërtime të pakontrolluara, arsye e kësaj gjendje janë planet ekzistuese dhe inspekcioni i suksesshëm. Toka bujqësore është shumë e rëndësishme, ajo është e mbrojtur me shumë masa

të ndryshme nga të cilat më e suksesshme është ngritja e vetëdijes për tokën dhe të mirat nga ajo.

Baza e shënimeve është njëra nga veglat më të rëndësishme e cila na mundëson që në çdo moment të monitorojmë dhe ta zhvillojmë hapësirën. Ortofotot janë siguruar nga buxheti i përbashkët i të gjitha njësive komunale dhe tani ato janë në shërbim të të gjithëve.

Edhe këtu ndihet problemi i statusit, punëtorët dhe stafi udhëheqës janë duke e pritur me padurim aprovimin e Ligjit të ri për PH me të cilin enteve për planifikim hapësinor u epet mundësia e konkurrimit dhe angazhimit në kryerjen e projekteve edhe për palët e treta.

Në kuadër të rajonit është themeluar Agjencia për Zhvillim Rajonal me status privat e cila është njëra nga faktorët e zhvillimit të rajonit. Në bazë të projekteve (nga të cilat ajo financohet) që janë realizuar nga ky agjencion për dhjetë vite janë investuar 50 milion Euro nga të cilat më së shumti kanë përfituar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Agjencioni e ka planin e vet të punës, me të cilin parashihen vizita nëpër të gjitha njësitë komunale. Nga këto takime merren rekomandimet dhe në këtë mënyrë bëhet programi i ardhshëm i investimeve. Njëri nga burimet për këto investime është fondi evropian në kuadër të të cilit janë programe të ndryshme për zhvillimin e rajoneve (INERREG etj.). Në kuadër të Agjencionit punojnë ekspert të fushave të ndryshme të cilët në bashkëpunim me Entin e planifikojnë zhvillimin dhe realizimin e planit zhvillimor për rajonin.

### **Takimi në Komunën Sveti Krizh Zaçërtje**

Më tutje takimet tona kanë vazhduar në komunën e Sveti Krizh Zaçërtje, në të cilën u organizua takim me kryetarin e komunës dhe stafin e tij. Takimi u organizua në një ambient tradicional që njëherit ishte edhe një dëshmi shtesë se në Kroaci trashëgimisë kulturore dhe tradicionale po i epet kujdes i veçantë. Nga kryetari i komunës mësuam për organizimin e komunës, planet dhe programet për zhvillim si dhe problemet që ballafaqohet komuna. Raporti me nivelin qendror është shumë i ngushtë, pas marrjes së vendimeve nga niveli qendror, komuna është përgjegjësjë e vetme e realizimit të planeve. Në komunë është aprovuar PH dhe në bazë të tij realizohen të gjitha zhvillimet. Ortofotot dhe kadastrin digjital janë veglat kryesore me të cilat bëjmë shitblerjen shumë efikase të tokës. Blerësi potencial që në fillim i ka të gjitha të dhënat për tokën për të cilën është i interesuar (destinimin, infrastrukturën, pronarin dhe të gjitha të dhënat e nevojshme). Kjo mënyrë e shpejton shumë procedurën, ka raste që edhe ditëve të pushimit këto transaksione janë kryer me sukses. Të gjitha shënimet për blerësin e ri pastaj dërgohen në kadastrë dhe në këtë mënyrë bëhet azhurimi i shpejtë dhe gjendja e letrave në çdo moment i përgjigjet gjendjes në terren. Në tokën bujqësore dhe në pyje nuk është i lejuar ndërtimi, janë të lejuar vetëm 30 m<sup>2</sup> në emër të objektit të përkohshëm, i cili lehtëson punën e bujkut në arë. Në mënyrë shumë efikase është zgjidhur problemi i mbeturinave, nga komuna sigurohen qeset e najlonit me madhësi të ndryshme dhe varësisht nga madhësia është edhe çmime i shtypur në to. Çdo qytetarë është i obliguar ti përdor vetëm këto qese dhe në bazë të qeseve të dorëzuara e paguan edhe çmimin.



Një angazhim serioz janë duke i kushtuar agro-turizmit, nga profesori i angazhuar për këtë çështje mësuam se është në fazën e implementimit një projekt në bazë të të cilit në bashkëpunim me bankat me kushte shumë të volitshme, shpallen për çdo vit tenderë për kreditim të këtij lloj turizmi. Në këtë mënyrë stimulohet prodhimi i produkteve tradicionale të cilat janë shumë në trend dhe çmohen nga turistët.

Në vazhdim të takimit u organizua edhe një vizitë e shkurtër në një objekt të trashëgimisë kulturore (XVI), pronë e një familje të vjetër kroate. Të gjitha investimet në restaurimin dhe rekonstruimin e objektit ishin të familjes e cila qëllimin kryesor e kishte ta kthej objektin në rezidencë familjare dhe një pikë të rëndësishme për turizëm në komunë.

### **Takimi në Komunën Delnice**

Takimi u organizua në zyrat e komunës me nikoqir zëvendës kryetarin e komunës. Komuna Delnice shtrihet në pjesën veriore të Kroacisë, shumë afër me Slloveninë. Kjo komunë është e njohur për faktin se në kohën e luftës në Kroaci ka qenë mbështetja kryesore e ushtarëve kosovar (afërsisht 300) që atë kohë dezertonin nga Ushtria Jugosllave. Një kohë të njëjtit janë mobilizuar në ushtrinë kroate mirëpo sipas zv. kryetari është fat i madh që ata djem nuk i kemi angazhuar në front.



Kjo komunë i takon rajonit (Zhupanisë) Gorski Kotor që ka përafërsisht 140.000 banorë, me pozitë shumë të mirë gjeografike, me pyje të shumta që llogariten si pasuria më e madhe e këtij rajoni. "Investimi më i madh është që nuk kemi investuar" gjë që ka ndikuar në ruajtjen e mjedisit.

Parku Nacional "Risnjak" i jep mundësi të mëdha zhvillimit të turizmit, po bëhen përpjekje të mëdha që ky rajon të shpallet zonë ekologjike e Evropës. Edhe në këtë komunë bujqësia dhe tradicionalja janë të favorizuara. Këtu mund të porositni për drekë përshutë të ariut ose ujkut, e cila gjë nuk mund të provohet në Evropë. Në këtë drejtim edhe Kosova ka resurse dhe mundësi të shumta, në të cilat duhet me çdo kusht të insistohet. Speciat e mbushur, Oeni i Sharrit, Djathi i Sharrit, artizanatet dhe zakonet tradicionale mund të jenë një burim i pashtershëm i të hyrave për ekonominë kosovare.

Baza e të dhënave edhe këtu është njëra ndër veglat kryesore të funksionimit të komunës. Nga niveli qendror është urdhëruar që të regjistrohet e gjithë prona dhe e cila nga njësia e GIS-it që është e instaluar në komunë të dhënat digjitalizohen dhe bëhen të gatshme për manipulim. Në çdo moment jemi të gatshëm që për investitorët të japim informatat e nevojshme për çdo pjesë të territorit pa të cilat informata nuk mund të bëhet asgjë.

Lartësia më e madhe është 1500 m ndërsa më e ulëta Lumi Kupa 200 m, ndërsa qyteti i Delnices ndodhet në lartësinë mesatare prej 700 m, këtu përfundojnë Alpet dhe fillojnë malet Dinarite.

Në kuadër të komunës funksionon "shoqata e të ecurit" e cila promovon ecjen në vend të vozitjes duke ndikuar në këtë mënyrë në ruajtjen shumë të rëndësishme të mjedisit.

### **Takimi në Drejtorinë e Parkut Nacional "Risnjak"**

Në fillim të takimit u prezantua filmi për PN "Risnjak", një material shumë i mirë i promovimit dhe publicitetit të Parkut. Parku është themeluar në vitin 1953 dhe është i treti me vjetërsi në Kroaci.

Përgjegjëse për mbrojtjen e Parkut është Ministria e Kulturës e cila edhe e ka shpallë Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës në bazë të të cilit edhe ky Park funksionon dhe zhvillohet. Ndërsa niveli më i ulët është rajoni (Zhupania) e cila është përgjegjëse për nivelet tjera të mbrojtjes si park-pyjet, pejsazhet natyrore etj.



Plani Hapësinor për Parkun është më tepër destinim i sipërfaqeve i cili patjetër duhet të mbështetet edhe me Planin për Menaxhimin e Parkut i cili në mënyrë detaje tregon se çka, ku dhe si duhet të zhvillohet.

Me Parkun udhëheqë drejtori, të cilin e emëron për çdo katër vite Ministria e Kulturës e cila gjithashtu emëron bordin mbikëqyrës në përbërje të profesionistëve, vendorëve dhe përfaqësues të politikës të cilat kanë për detyrë të monitorojnë zhvillimet në Park.

Në park janë të punësuar 26 veta (në bazë të rregullores duhet të jenë 56) të ndarë në disa sektorë: sektori mbikëqyrës, sektori profesional, sektori teknik, shërbimet e turizmit dhe marketingut (e cila udhëhiqet komplet nga vet drejtorja) dhe administrata.

Buxheti sigurohet: nga të hyrat 50% (shitja e suvenireve, bujtjet) dhe nga Ministria 50%, më herët ky raport ka qenë 70 me 30 që do të thotë se viteve të ardhshme buxheti nga Ministria do të zvogëlohet gradualisht.

Projektet që i realizojmë përmes donacioneve të Bashkësisë Evropiane janë një burim tjetër i buxhetit – kohëve të fundi Banka Botërore me një projekt të sanimit ka ndihmuar Parkun me 5 milion dollarë.

## Disa të dhëna themelore për Kroacinë

- Republikë parlamentare shumëpartiake
- Përbëhet prej 20 regjioneve (Zhupanive) dhe 1 qytet si njësi e pavarur territoriale,
- Sipërfaqja: pjesa tokësore 56.542 km<sup>2</sup> ndërsa sipërfaqja e detit 31.067 km<sup>2</sup>
- Popullsia: 4.437.460 b. Përkatësia nacionale: shumica kroat ndërsa pakicat janë: serb, slloven, hungarezë, boshnjak, italian, çekoslovak etj.
- Dendësia: 78 b/ km<sup>2</sup>
- Kryeqyteti: Zagrebi me 779.145 b. – qendër ekonomike, tregtare, kulturore dhe akademike,
- Gjatësia e bregdetit 5835 km. Nga të cilat 4058 janë brigje të ujdhesave, (Bregdeti kroat përfshin pjesën më të madhe të detit Adriatik),
- Numri i ujdhesave: 1185, nga të cilat më të mëdhatë janë Kërka dhe Cres ndërsa të banuara janë vetëm 50 ujdhesa,
- Maja më e lartë: Dinara me 1831 m/nm
- Valuta: kuna (kuna = 100 lipa)

## Mësimet e mësuara dhe mundësia e implementimit të tyre

Vizita ishte shumë e suksesshme dhe ne konsiderojmë që përvojat e fituara atje do të jenë preokupim i yni në projektet e ardhshme. Disa nga këto përvoja i kemi shkoqitur si më prioritare dhe do të mundohemi që me çdo kusht ti gjejmë format e duhura për implementim.

1. Organizimi dhe nivelet e planifikimit – organizimi shumë i mirë i cili ka mundësuar që çdo njësi administrative të jetë e mbuluar me plan;

Në Kosovë, edhe pse janë bërë disa hapa më herët në fushën e planifikimit jemi duke i bërë hapat e parë serioz në drejtim të planifikimit strategjik. Ne do të përpiqemi që këtë frymë ta ndërtojmë në të gjitha nivelet duke filluar nga fshatrat dhe komunat e vogla e deri te ato të mëdhatë dhe niveli qindor. Do të fillojmë negociatat me disa komuna të vogla për fillimin e procesit të planifikimit, në të cilin do të kyçemi së bashku me autoritetet e komunale.

2. Përshtatja e rregullativës ligjore me rregullativen evropiane – krijon përparësi në integritet evropiane;

Kjo dukuri është duke ndodhur edhe tek ne me një vështirësi të vogël e cila për shkak të statusit të pazgjidhur po na sjellë në situatë që ligjet e hartuara dhe të aprovuara për shkak të specifikave, të kthehen prapa dhe të hartohen serish. Së shpejti do të fillojmë një projekt së bashku me UNDP-në, gjatë të cilit në disa javëve do të mësojmë për institucionet evropiane, ligjet dhe rregulloret që përdoren atje dhe mundësinë e harmonizimit të të gjitha këtyre në drejtim të integritetit.

3. Ndryshimi i legjisllacionit në Ministrinë e Mjedisit, Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërtimit – i ofron mundësi institucioneve që merren me planifikim hapësinor në kuadër të Qeverisë qendrore dhe rajonale të kenë status gjysmë privat. Kjo do të ndikojë në ngritjen e efikasitetit, kualitetit dhe ekzistencës së institucioneve të krijuara me mund.

Iniciativa e ndryshimit të statusit të Institutit për Planifikim Hapësinor që është duke funksionuar në kuadër të Ministrisë do të fillojë së shpejti. Ne kemi përgatitur një draft propozim për ndryshimin e statusit, me të cilin do të fillojmë debatin me autoritetet përgjegjëse. Ky dokument me siguri se do të fuqizohet edhe me rastin e Kroacisë si shembulli më i freskët dhe më praktik, që në mënyrë të qartë dëshmon se kjo përpjekje është e drejtë dhe në momentin e duhur.

4. Niveli lokal i organizuar mirë – pas përfundimit të planeve komunale në zgjidhjen e të cilave ndikon edhe niveli qindor, komuna i ka të gjitha ingerencat në implementimin e tyre.

Shumë e njerëzve në Kosovë, nuk e dinë dallimin në mes institucioneve. Ata nuk e kuptojnë kush i merr vendimet të cilat ndikojnë te ata dhe nuk e ndejnë aktin institucional si mekanizëm efektiv për arritjen e qëllimeve të veta. Në përpjekjen tonë për të filluar procesin planifikimit në komunat e vogla, njëra nga aktivitetet e rëndësishme do të jetë edhe fushata për ngritjen e vetëdijes në këtë fushë, në mënyrë që edhe qytetarët të bëhen element i rëndësishëm në marrjen e vendimeve.

5. Sistemi gjeografik i informatave (GIS) – është njëra ndër veglat më të fuqishme në të gjitha nivelet e sidomos në atë lokal. Çdo pjesë e komunës është e regjistruar në libra të



kadastrit dhe çdo ndryshim i destinimit përmes GIS-sistemit ajo shpejt digjitalizohet dhe bartet në libra me të gjitha informatat e nevojshme.

Njëra ndër kërkesat dhe prioritetet në fushën e planifikimit hapësinor do të jetë futja e sistemit të GIS-it në të gjitha nivelet. Së pari është propozuar që të gjitha komunat e mëdha (shtatë qendrat: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjilani) të pajisen me këtë sistem i cili në fillim do të mund të kryente shërbime edhe për qendrat e vogla që janë përreth. Duke qenë të vetëdijshëm për buxhetin e vogël do të propozojmë që ky projekt të futet në kuadër të donacioneve dhe ndihmave që po japin organizatat e ndryshme që punojnë dhe veprojnë në Kosovë.

6. Menaxhimi i mbeturinave shumë efikas – përdorimi i qeseve të plastikës me madhësi dhe çmime të ndryshme. Qeset shpërndahen falas nga organet komunale, dhe vetëm përmes këtyre qeseve familjet mund ti hedhin mbeturinat.

Në takimet e ardhshme që do ti kemi me autoritetet komunale dhe qendrore përgjegjëse për mjedisin, shembullin e Kroacisë do ta propozojmë për ta aplikuar së paku në një pilot-komunë e cila do shërbejë si provë për aplikimin edhe në komunat tjera.

7. Ruajtja e trashëgimisë kulturore – objekti i vjetër rezidencial është mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit për komunën e vogël.

Degradimi trashëgimisë kulturore është njëra nga çështjet kryesore e trajtuar në Planin Hapësinor të Kosovës. Rasti i Kroacisë do të shërbejë si rast praktik të cilin do ta përdorim në takimet që do ti kemi me Ministrinë e Kulturës. Temë e këtyre takimeve do të jetë ruajtja e objekteve dhe tërësive kulturore të cilat kanë status të mbrojtjes. Në mungesë të buxhetit shtetëror, do të propozojmë që të aplikohet rasti i Kroacisë ku pronari i objektit do të hartojë projektin për rehabilitim me të cilin konkurrohet në fonde të bollshme evropiane për këtë fushë.

8. Parqet nacionale dhe menaxhimi i tyre – me parkun udhëheqë drejtori i përzgjedhur çdo katër vite nga Ministria, i cili punon nën mbikëqyrjen e bordit që përbëhet nga profesionist të ndryshëm. Stafi i drejtorisë së Parkut është i ndarë në disa njësi në mesin e të cilave ajo e marketingut është më me ndikim.

Ky është rast shumë praktikë se si duhet të udhëhiqet një park nacional. Ne jemi në proces të hartimit të planit hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr" dhe njëra ndër sfidat kryesore është menaxhimi i drejtë me Parkun. Momentalisht në Park janë tre subjekte përgjegjëse që kanë ndikim në menaxhim me Parkun. Kjo është edhe arsyeja e gjendjes shumë të keqe të Parkut, dhe ne do të propozojmë që kjo gjendje të ndërrohet duke aplikuar sistem të menaxhimit të ngjashëm me Kroacinë.

9. Shitoret e librave – ishte shumë mbresëlënëse numri i madh i shitoreve të librave në qytetin e Zagrebit. Ky është një tregues i rëndësishëm që tregon interesimin e madh të qytetarëve ndaj librit.

Në Prishtinë ekzistojnë një ose më së shumti dy shitore të specializuara të librit, kjo është gjendja momentale e raportit të kërkesës dhe ofertës për librin për qytetarët e Prishtinës. Kjo është fatkeqësisht pasqyrë reale e interesit momental të qytetarëve për librin, në ndryshimin pozitiv të të cilit do të mundohemi të ndikojmë në të gjitha mënyrat.